



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.12.2018, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit,
2. Projektvendimi “Për një shtesë dhe ndryshim në strukturën dhe organikën e Autoritetit të Konkurrencës”.
3. Projektvendimi “Për miratimin e strukturës organizative të Institutit të Statistikave”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhavit Bushaj dhe Pjerin Ndreu.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Reme Lala, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Juliana Latifi – Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës,
Delina Ibrahimaj – Drejtore e Përgjithshme e INSTAT-it
Alban Cela – Drejtor i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
Klajd Shuka – Drejtor i Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse
Maldi Dema – koordinator për Sistemin Kombëtar Statistikor
Elsa Dhuli – koordinator për Cilësinë Statistikore
Vilma Causholli – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Suzana Kosta – përgjegjëse e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Strukturave dhe Pagave në Departamentin e Administratës Publike.

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje kemi shqyrtimin e dy çështjeve:

Së pari, projektvendimin “Për një shtesë dhe ndryshim në strukturën dhe organikën e Autoritetit të Konkurrencës”.

Së dyti, projektvendimin “Për miratimin e strukturës organizative të Institutit të Statistikave”.

Fillojmë me çështjen e parë. Të ftuar kemi kryetaren e Autoritetit të Konkurrencës, zonjën Juliana Latifi, e cila do të prezantojë kërkesën ndaj këtij komisioni.

Zonja Latifi, e keni ju fjalën.

Juliana Latifi – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Ne kemi paraqitur kërkesën “Për një shtesë dhe ndryshim në strukturën organike të Autoritetit të Konkurrencës”, e cila është e bazuar në kuadrin ligjor. Kërkesën tonë e bazojmë në disa faktorë:

Së pari, ka të bëjë me progresraportin e Komisionit European për Shqipërinë, i cili shprehimisht thekson: “Autoriteti i Konkurrencës duhet të forcojë në mënyrë të vazhdueshme kapacitetet institucionale”.

Së dyti, ka të bëjë me vetë rolin që luan Autoriteti i Konkurrencës, duke qenë lider dhe koordinator i një kapitulli në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, “Politikat e konkurrencës dhe liberalizimi”.

Së treti, lidhet me inspektimin e tregjeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përbën një nga elementet e rëndësishëm të kësaj kërkeje që ne i parashtrojmë Komisionit të Ekonomisë.

Viti 2018 është shoqëruar me hetimin e disa sektorëve apo tregjeve, të cilat më parë nuk janë prekur nga Autoriteti i Konkurrencës. Këtu mund të përmend tregun e shërbimit spitalor, tregun e arsimit të lartë, tregun e profesioneve të lira dhe tregun e sportit.

Ajo që është e rëndësishme në evidentimin e kërkesës sonë lidhet me numrin e kufizuar të inspektorëve që realizojnë këto inspektime në tregjet përkatëse në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe aktualisht janë 25 inspektorë. Sot në larminë e tregjeve këto nuk janë më tregje tradicionale, por janë specifike.

Autoriteti i Konkurrencës në planin afatmesëm ka parashikuar që për vitet 2019–2021 të ketë një shtesë në staf prej 9 personash dhe nga Komisioni i Ekonomisë kërkojmë që

kjo shtesë të merret në konsideratë. Kjo lidhet me strukturën e re të Autoritetit të Konkurrencës që vetë Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar në vitin 2017 dhe ka të bëjë me pozicionin e “*Cheap ekonomisë*”, i cili është një pozicion i diktuar nga standardet e Bashkimit Europian. Në kuadër të kësaj strukture ne synojmë që me numrin e kërkuar të krijojmë dhe njësinë “*Cheap ekonomist*”.

Do të doja që kjo kërkesë të parashikohet në ndryshimet e aktit normativ për buxhetin që ju si komision mund të bëni në qershor të vitit 2019.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

A ka pyetje?

Deputet – Ne e miratuar buxhetin dhe shtimin e punonjësve, çfarë kërkojnë më shumë?

Erion Braçe – Zonja Latifi, për këta tre punonjës kërkon jo vetëm miratim strukturë, por dhe buxhet apo jo?

Juliana Latifi – Ne kërkojmë edhe buxhet, por përderisa buxheti ka kaluar kërkojmë që të miratohet kjo shtesë në strukturë dhe më pas në ndryshimin e aktit normativ që do të bëhet për buxhetin, në qershor të vitit 2019, do të parashikohet edhe shtesa në buxhet.

Erion Braçe – Po, kështu po.

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Zonja Latifi unë mendoj që ky komision ka detyrimin që të përmbushë të gjitha detyrimet që Autoriteti i Konkurrencës ka dhe burojnë nga ligji, por edhe detyrimet që ka në procesin e përafrimit, me kriteret dhe standardet e Bashkimit Europian, pra detyrimet që rrjedhin nga ai proces. Ne jemi të gatshëm ta miratojmë këtë kërkesë për strukturën, por financimi i buxhetit të shtetit është mbyllur me projektbuxhetin e vitit 2019. Ministri i Financave ishte këtu dhe nuk pranoi kërkesën tonë për të shtuar me tre punonjës strukturën e Autoritetit të Konkurrencës, prandaj ne miratojmë këtë dhe mbetet që Ministria e Financës të përfshijë me një akt të dytë, kur ai të ndodhë gjatë vitit 2019, plotësimin me një fond shtesë për 3 personat që do të bëhen pjesë e Autoritetit Mbikëqyrës Financiar.

A jeni dakord?

Juliana Latifi – Dakord.

Erion Braçe – Në projektvendim të reflektohet kjo gjë.

Hedhim në votim projektvendimin me këtë ndryshim dhe pastaj e kalojmë në seancë plenare, me shoqërimin për Ministrinë e Financave.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.12.2018, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektvendimi “Për miratimin e strukturës organizative të Institutit të Statistikave”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhavit Bushaj dhe Pjerin Ndreu.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Reme Lala, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Delina Ibrahimaj – Drejtore e Përgjithshme e INSTAT-it

Alban Cela – Drejtor i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Klajd Shuka – Drejtor i Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse

Maldi Dema – koordinator për Sistemin Kombëtar Statistikor

Elsa Dhuli – koordinator për Cilësinë Statistikore

Vilma Causholli – Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Suzana Kosta – përgjegjëse e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Strukturave dhe Pagave, në Departamentin e Administratës Publike.

Erion Braçe – Vazhdojmë me Institutin e Statistikave.

Për projektvendimin e dytë, që ka të bëjë me strukturën e Institutit të Statistikave, ndodhet në Komisionin e Ekonomisë drejtorja e Përgjithshme e INSTAT-it, zonja Adelina Ibrahimaj.

Zonja Ibrahimaj, e keni ju fjalën për të prezantuar.

Adelina Ibrahimaj – I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Sot INSTAT-i paraqet strukturën organizative, e cila është përgatitur për ecurinë e suksesshme të programit të statistikave zyrtare. Miratimi i kësaj strukture është në zbatim të dispozitave kalimtare të ligjit “Për statistikatat zyrtare”, e cila u miratua në maj të këtij viti.

Sistemi statistikor zyrtar po përballë me sfida të mëdha, të cilat lindin nga kërkesa gjithmonë në rritje për prodhim të treguesve të rinj statistikor së bashku me kërkesat për rritjen e eficiencës dhe efikasitetit. Në ndërtimin e strukturës që paraqitet sot janë reflektuar rekomandime të dhëna nga raportet e progresraportit, për kapitullin 18 “Statistikatat”, si dhe ato të sugjeruara nga ekspertët e “EEROSAT-it”, FMN-së apo partnerë të tjerë kombëtarë apo ndërkombëtarë, gjatë misionëve të tjera vlerësuese për sistemin statistikor kombëtar në Shqipëri.

Nga struktura propozohet të krijohen tri drejtori të përgjithshme, të cilat, bazuar në fushat e përgjegjësisë së secilës duhet të mbajnë parasysh kërkesat për statistikatat kombëtare dhe të asistojnë drejtorin e përgjithshëm për menaxhimin e institucionit. Këto struktura do të përcjellin synimet dhe vizionin e menaxhimit në tri drejtime të institucionit në agjenci të tjera statistikore, duke përmbyllur rolin e ri që ka INSTAT-i, në vijim të miratimit të ligjit “Për statistikatat zyrtare”, si koordinator i sistemit kombëtar statistikor.

Domosdoshmëria e krijimit të drejtorive të përgjithshme lidhet edhe me rritjen e performancës së institucionit me drejtimin, menaxhimin, monitorimin dhe ndjekjen në çdo aspekt të realizimit të statistikave zyrtare. Drejtoritë e përgjithshme që do të krijohen sipas fushës së përgjegjësisë janë:

Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor e lidhur drejtpërdrejt me aktivitetin prodhues të këtij institucioni. Kjo drejtori do të asistojë drejtorin e përgjithshëm në menaxhimin e prodhimit statistikor, në kontrollin e zbatimit të metodologjive dhe standardeve ndërkombëtare për të garantuar cilësinë e prodhimit të statistikave zyrtare.

Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë, Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënave do të shërbejë për të asistuar drejtoritë përbërëse në çështjet e mbledhjes së të dhënave, menaxhimit të tyre dhe metodologjinë e prodhimit statistikor. Kjo drejtori mbështetëse e

themelit të prodhimit statistikor do të punojë për të përmbushur kërkesat e vazhdueshme për implementimin e metodave të reja për modernizimin e sistemit kombëtar statistikor, të cilat do të garantojnë parimin bazë të kostoeftektivitetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe e Koordinimit do të shërbejë për të krijuar, koordinuar dhe bashkërenduar në mënyrë efeciente burimet që janë në dispozicion për çështjet e prodhimit statistikor të infrastrukturës.

Drejtoritë brenda drejtorive të përgjithshme janë grupuar në një formë të tillë për të ruajtur vazhdueshmërinë e realizimit të aktiviteteve në proces dhe përgjegjësi në përmbushjen e programit të statistikave zyrtare gjatë viteve 2017 – 2021, si dhe strategjinë shumëvjeçare të institucionit duke pësuar ndryshime të vogla funksionale. Këto ndryshime paraqesin edhe kërkesat në vijim të detyrimeve që INSTAT ka dhe raportimet për përdoruesit ndërkombëtar të të dhënave.

Risi tjetër e strukturës është krijimi i pozicionit të sekretarit të përgjithshëm. Në zbatim të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, drejtori i përgjithshëm nuk është më nëpunës civil, prandaj krijohet pozicioni i sekretarit të përgjithshëm në Institutin e Statistikave që është nëpunësi më i lartë civil në institucion.

Risi është edhe krijimi i dy drejtorive të reja, Drejtoria e Koordinimit dhe e Çështjeve Ligjore dhe Drejtoria e Komunikimit dhe e Publikimeve.

Në total numri i punonjësve në Institutin e Statistikave shkon nga 216, që ishin në fillim, në 236. Për këtë ndryshim është marrë miratimi i Ministrisë së Financave dhe Departamenti i Administratës Publike dhe janë përfshirë në ligjin e ri për buxhetin.

Mirëfunksionimi i INSTAT-it me këtë strukturë organike përputhet me hierarkitë dhe funksionet e administratës publike në Shqipëri. Struktura brenda drejtorive apo sektorëve janë konform kërkesave për të ndërtuar një sistem statistikor funksional, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm në vend dhe për t’iu përgjigjur sfidës së madhe të integrimit europian që ka INSTAT, i cili jo vetëm është përgjegjës për kapitullin 18, por është kontribuues edhe në të gjithë artikujt e tjerë.

Kam besim të plotë që miratimi nga ana juaj i kësaj strukture do të shpejtojë procesin e integrimit europian dhe do të ndërtojë një marrëdhënie të re të qëndrueshme me Kuvendin e Shqipërisë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

A ka pyetje? Fjalën e ka zoti Ndreu.

Pjerin Ndreu – Faleminderit!

Duke falënderuar zonjën për shpjegimin dhe duke shprehur edhe respektin për institucionin që është shumë dinjitoz, si deputet i Lezhës, dua të di për organizimin e strukturave më poshtë, pra në rrethe, meqë strukturimi sipër është i mirorganizuar. Ne nuk merremi me strukturën tuaj, por kam vënë re që ka një organizim pa kokë te zyra që keni në Lezhë, ku punojnë disa persona, por nuk kanë një njeri që t'i drejtojë. Të gjithë janë në rrolin e specialistëve dhe kam dëgjuar që ka pasur edhe përplasje mes tyre. A mundeni të vendosni një drejtues në krye të këtyre zyrave, që të dihet se në linjën e poshtme është dikush që përgjigjet.

Faleminderit!

Adelina Ibrahimaj – Struktura që paraqitet nuk planifikon të bëjë ndryshime për drejtoritë rajonale, pasi mendojmë që struktura e INSTAT-it duhet të vijë e organizuar sipas strukturave të tjera të drejtorive të përgjithshme të qeverisë, e cila është e organizuar në katër rajone, ku Lezha është në varësi të Shkodrës. Këto struktura varen nga një drejtori brenda Institutit të Statistikave. Meqenëse Shqipëria ka një sipërfaqe të vogël, ne kemi menduar që zyra e Lezhës të ketë një rol koordinues të punës në terren dhe jo menaxhues. Kjo është arsyeja përse zyra e Lezhës nuk ka një përgjegjës zyre, sepse varet nga Shkodra dhe pastaj nga Tirana.

Erion Braçe – Më lejoni edhe mua t'ju pyes, cili është efektiviteti i këtyre zyrave në territor? A matet efektiviteti i punës së tyre?

Adelina Ibrahimaj – Zyrat kryesish merren me koordinimin e anketave, shpërndarjen e anketave në terren, koordinimin e anketuesve, mbledhjen e anketave në zyra dhe dërgimin e tyre në Tiranë, pra kanë një rol koordinues.

Erion Braçe – A funksionon kjo?

Adelina Ibrahimaj – Po, aktualisht funksionon. Pra, kanë vetëm rol ekzekutiv dhe nuk kanë rol për hartimin dhe kryerjen e statistikave.

Erion Braçe – Nuk e diskutoj këtë pjesë, por kjo gjë funksionon, apo jo?

Adelina Ibrahimaj – Po, logjistika funksionon.

Erion Braçe – Dakord. A ka pyetje të tjera?

Fjalën e ka zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit për shpjegimet që dhatë!

Në kuadër të asaj që tha kolegu, çfarë problemi ka nëse njërën nga punonjësit ta etiketoni si të parin e kësaj pune ose ta bëjnë me rotacion, sepse një zyre pa kokë nuk ka kuptim, jo për titull dhe as për rrogë, por të ketë një përgjegjës zyre.

Erion Braçe – Unë mendoj që hierarkia që tregoi zonja është e duhura, pastaj a funksionon apo jo është çështje tjetër, sepse kontrolli nga Shkodra në Lezhë ka një lloj problematike. Por edhe historia që për çdo tre shqiptar duhet të ketë një drejtor është si pakuptim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj pyeta nëse funksionon apo jo. Tani funksionimi gjithmonë me drejtorë, sikur nuk funksionon, sepse edhe aty janë dy drejtorë zihen njëri me tjetrin se duan të dy të jenë udhëheqës.

Adelina Ibrahimaj – Ne mendojmë se ashtu siç ka funksionuar aktualisht do të vazhdojë të funksionojë. Roli i shefave të zyrës nëpër qarqe apo rrethe është i lidhur me firmën për proceset financiare. Lezha nuk ka...

Erion Braçe – Zonjë edhe një herë, shqetësimi që ka zotëria ka të bëjë me funksionimin e kësaj zyre, duke filluar që nga disiplina e orarit deri te produktiviteti i punës. Nëse ju e kontrolloni nga Shkodra në Lezhë, kjo është histori tjetër, por, nëse ju nuk e kontrolloni, shikoni se si mund të gjeni një zgjidhje që kjo punë të ketë produktin, efektivitetin por edhe disiplinën. Kam përshtypjen se kur njërin nga punonjësit e pyesin në rrugë se ku po shkon, ai i thotë: “po shkoj në punë”; Po ku punon? Ai i përgjigjet: “Te INSTAT-i” dhe shkon në punë në orën 9:00. Pra, duhet kontrolluar edhe kjo gjë, sepse po paguajmë para dhe po miratojmë struktura shtesë, prandaj duam efektivitetin dhe produktin e tyre. Këta punonjës, kudo që ndodhen si në Lezhë, në Lushnjë, apo në Skrapar, duhet të jenë njerëz seriozë në raport me punën, me qëllim që ne të marrim atë produkt që kërkohet sipas ligjit.

A ka ndonjë pyetje tjetër që lidhet me strukturën?

Xhavit Bushaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, drejtoreshë për shpjegimin!

Kërkesa juaj për strukturën e re a ka efekte financiare dhe ndryshime në buxhet apo me fondet që janë kaluar mund të bëhen ndryshime në strukturë?

Erion Braçe – Zoti Bushaj, ju jeni shumë afër dhe duhet ta kishit dëgjuar që shtesa për të cilën bëhet fjalë është miratuar në këtë komision, pastaj në Kuvend dhe Ministria e Financave ka rënë dakord.

A ka ndonjë pyetje tjetër? Nuk ka.

Kalojmë në votim. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Komisioni të qëndrojë pak, sepse dua t'ju njoftoj që nesër kemi për të shqyrtuar dekretin e Presidentit lidhur me buxhetin e shtetit, çështjen e kandidaturave të qeverisë dhe të Kuvendit për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë me seancë dëgjimore dhe pastaj me vendimmarrjen në seancën plenare dhe në fund kemi për të diskutuar çështjen e dekretit të Presidentit për nominimin e kandidatit për kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretari i komisionit
Elvi Prifti